



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.03.2021, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rend i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 18, 19 dhe 24 shkurt 2021.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit nga data 1– 19 mars 2021.
3. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës””. (*Komisioni përgjegjës*)
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me konventën ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det (1974)”. (*Komisioni për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha Gjebrea, Alket Hyseni, Eglantina Gjermeni, Ervin Bushati, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Ligoraq Karamelo, Xhemal Qefalia, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Halit Valteri, Fatmir Velaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Andrea Marto dhe Vasilika Hysi.

Të ftuar:

Pandeli Majko – Ministër i Shtetit për Diasporën
Sonila Hysi – Drejtoreshë Ekzekutive e Agjencisë së Diasporës
Klaudia Hasanllari – Drejtoreshë e Drejtorisë së Diasporës në Ministrinë e Shtetit për Diasporën
Etjen Xhafaj – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli – Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Transportit Detar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana – Specialisti i Sektorit të Politikave të Transportit Detar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 2.03.2021 me këtë rend dite: miratimi i procesverbaleve të datave 18, 19 dhe 24 shkurt 2021, s miratimi i kalendarit të punës së komisionit nga data 1 – 19 mars 2021, si dhe shqyrtimi i dy projektligjeve. Njërin e kemi për shqyrtim nen dhe në tërësi, pra e kemi shqyrtuar praktikisht vetëm në parim dhe bëhet fjalë për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës””, i cili vjen si propozim nga kolegu Shameti. Jemi komision përgjegjës dhe relator kemi kolegun Hyseni. Shtesat dhe ndryshimet në ligjin nr. 115/2017 i janë bashkëlidhur materialit që të gjithë ju keni marrë nëpërmjet postës elektronike.

Më pas kemi shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me konventën ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det (1974)”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore kemi zonjën Gjermani.

Shikoj që kuorumi është i plotësuar, ndërkohë që kam kënaqësinë sot të kem pranë prezent me mua kolegun Fate Velaj. Kështu që ju shikoj të tjerëve që jeni të gjithë në ekran. Të ftuar kemi zotin Majko, ministër i Shtetit për Diasporën. Mirë se vini, kolegu Majko! Kemi zonjën Hysi, drejtoreshë ekzekutive e Agjencisë së Diasporës, si dhe zonjën Hasanllari, drejtoreshë e Drejtorisë së Diasporës.

Ndërsa lidhur me diskutimin për projektligjin e dytë, shpresoj të kemi në linjë zëvendësministrin Xhafaj e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkë me zotërinjtë Plaku, Karoli dhe Thana, respektivisht drejtor, përgjegjës sektori dhe specialist.

Mirë se vini, zotërinj, të gjithë!

Fillojmë, pa humbur kohë, me miratimin e procesverbaleve të datave 18 dhe 19. Kush është dakord? Shikoj që nuk ka kundërshtim. Shikoj që jemi të gjithë dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohen.

Vijojmë me miratimin e kalendarit të punës së komisionit nga data 1 – 19 mars 2021. Nëse nuk keni ndonjë gjë me kalendarin, e konsideroj të miratuar.

Fillojmë, pa humbur kohë, me shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës””, për të cilin kemi diskutuar dhe kemi rënë dakord në parim për ndryshimet.

Nuk e di nëse është e nevojshme, kolegu Shameti, të shtoni diçka, apo kolegun Hyseni.

Adnor Shameti – Po.

Mimi Kodheli – Po, kolegu Shameti, fjala është për ju fillimisht.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë, për procedurë, desha të bëja një ndërhyrje.

Duke qenë se diskutimin në parim të projektligjit e bëmë mbledhjen e shkuar të Komisionit për Politikën e Jashtme dhe duke qenë se nga sekretaria e komisionit u është depozituar dhe u është dërguar të gjithë kolegëve anëtarë të Komisionit për Politikën e Jashtme tabela përmbledhëse me gjuhën që ka pasur ligji ekzistues, ndryshimet që propozohen të bëhen dhe ajo që është përfundimtare, që të jemi operativë, do t'ju lutesha që relatori të vijojë direkt me variantin përfundimtar, ashtu siç është në tabela, dhe të kalonim në miratimin nen për nen të atyre ndryshimeve përfundimtare.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Okej, faleminderit, kolegu Shameti!

Kolegu Hyseni, fjala për ju.

Alket Hyseni – Jam dakord, zonja kryetare.

Përshëndetje, së pari, të gjithë kolegëve!

Gjithsecili nga kolegët ka tabelën me ndryshime. Në kolonën e parë të saj është gjendja aktuale e ligjit dhe në kolonën e dytë kemi propozimin e ndryshimeve në projektligj, të cilat janë të pakta. Kështu, sikurse diskutuam edhe herën e kaluar, do t'ju ftojta t'i miratojmë, pasi janë ndryshime të cilat i mundësojnë agjencisë aktivitet më të lirshëm dhe më të shpejtë për përmbushjen e misionit të saj.

Nëse doni, mund të bëj edhe një përmbledhje për të rifreskuar edhe memorien e kolegëve, ose të kalojmë direkt nen për nen në miratim.

Mimi Kodheli – Unë besoj që të gjithë duhej ta kishim përpara këtë gjë. Megjithatë, në qoftë se ju e shikoni që dikush ka nevojë të rifreskojë ndryshimet për të cilat kemi diskutuar...

Adnor Shameti – I kemi në *e-mail*-e, kryetare, mendoj që nuk ka nevojë.

Mimi Kodheli – Okej, jeni të lirë.

Atëherë, kalojmë...

Nuk besoj që ministri Majko ka diçka për të shtuar. Keni? Nuk keni.

Faleminderit, Ministër!

Faleminderit, kolegë, për punën serioze që keni bërë lidhur me ndryshimet për thjeshtimin e punës së agjencisë dhe për disa precizime juridike të nevojshme.

Kalojmë menjëherë në votimin nen për nen.

Fillojmë me nenin 1. Kush është dakord me nenin 1? Po e ricitoj, po e riformuloj: “Në nenin 8 bëhen ndryshimet si vijon: 1. Shkronja “b” ndryshon me këtë përmbajtje” (përmbajtjen e keni në materialin që ju është dërguar).

2. Shkronja “ç” ndryshon me këtë përmbajtje?”. Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit?

Halit Valteri – Kryetare, unë nuk kam video, por jam pro. Jam Halit Valteri.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Valteri!

Atëherë, shikoj që jemi të gjithë pro, por ju citoj edhe për shkak të nevojës së regjistrimit në procesverbal.

(Ndërhyrje)

Jo, nuk është e nevojshme kolegu Velaj.

Atëherë, kolegët: Karamelo, Hyseni, Valteri, Shameti, Bushati, Braha, Gjermani, Gjebrea, Gjoni, Lala, Hysi, Sterjovski, Shtjefni, Velaj, Bushati dhe Qefalia janë të gjithë dakord.

Kalojmë te neni 2, të cilin po e citoj: “Pas neni 10 shtohet neni 10/1 me përmbajtjen si vijon” (përmbajtjen e keni në material). Kush është dakord me nenin 2? Shikoj të që të gjithë jemi dakord.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3, të cilin e citoj: “Në nenin 13 të pikës 1, pas fjalëve “autoritetet shtetërore”, të shtohen fjalët “dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Kush është dakord me nenin 3? Të gjithë dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4, të cilin e citoj: “Neni 16, pika 1, ndryshohet si më poshtë vijon” (tekstin e keni në material). Kush është dakord me nenin 4? Të gjithë pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 “Hyrja në fuqi” e ligjit. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Edhe një herë, do t’ju lutesha, zotërinj, në tërësi.

I konsideroj të miratuara propozimet e deputetit Shameti lidhur me disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Faleminderit, ministri Majko, për prezencën dhe kolegëve të tjerë!

Faleminderit, kolegë!

Pandeli Majko – Faleminderit juve!

Mimi Kodheli – Me të mira, Ministër!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.03.2021, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rend i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me konventën ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det (1974)”.*(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha Gjebrea, Alket Hyseni, Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Ligorag Karamelo, Xhemal Qefalia, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Halit Valteri, Fatmir Velaj dhe Reme Lala

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Andrea Marto dhe Vasilika Hysi

Të ftuar:

Etjen Xhafaj – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli – Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Transportit Detar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana – Specialist i Sektorit të Politikave të Transportit Detar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Mimi Kodheli – Kalojmë te projektligji i dytë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në lidhje me konventën ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det (1974)”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegja Gjermani.

Pa humbur kohë, Zëvendësministri Xhafaj, fjala është për ju, dy fjalë për projektligjin.

Etjen Xhafaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Kemi ardhur sot për prezantimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 në Konventën Ndërkombëtare “Për sigurinë e jetës në det” të vitit 1974.

Miratimi i projektligjit synon kryesisht të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e sigurisë lundrimore, duke amenduar konventën “Për sigurinë e jetës në det” (SOLAS) të vitit 1974, e cila është miratuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9213, datë 1.4.2004. Ky ka qenë versioni i protokollit të vitit 1974 dhe 1977, i cili është riparë më pas në vitin 1988 si pasojë e një incidenti ku kanë humbur jetën 193 pasagjerë.

Si pasojë e të gjitha konventave të tjera të Organizatës Ndërkombëtare të Lundrimit, janë bërë një sërë rishikimesh të kuadrit rregullator për sa i përket sigurisë së pasagjerëve në det, që kanë lidhje si me anijet që mbajnë flamurin e shteteve që kanë aderuar te kjo konventë, ashtu edhe anijeve me flamuj të huaj, të cilat tranzitojnë nëpër portet e shtetit, i cili aderon në këtë konventë.

Miratimi i këtij projektligji është në përputhje me strategjinë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016-2020, miratuar me VKM-në nr. 811, datë 16.11.2016, në të cilën objektivi i parë është përcaktuar përmirësimi i sistemit rregullator detar në pajtim me standardet e rregulloret e IMO-së dhe Bashkimit Europian dhe veprimi prioritar detar i ratifikimit dhe nënshkrimit të rregulloreve të këtyre organizatave mbi sigurinë dhe parrezikshmërinë detare, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin bregdetar.

Miratimi i projektligjit bëhet në zbatim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare për aderimin në të gjithë konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të kësaj organizate për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë. Projektligji i mësipërm ka si qëllim jo vetëm aderimin në protokollin e vitit 1988, por, gjithashtu, nuk sjell asnjë ngarkesë apo detyrim tjetër nga ana e strukturave institucionale dhe institucioneve publike për ndryshim strukture, shtim personeli apo pajisje të institucioneve zbatuese. Si pasojë, për

sa më sipër ne do të kërkonim mirëkuptimin tuaj për miratimin e këtij aderimi në këtë protokoll të rëndësishëm të Konventës Ndërkombëtare SOLAS.

Faleminderit, kryetare!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Fjalën e ka zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Projektligji që diskutojmë sot, dhe që dua ta falenderoj zëvendësministrin për prezantimin e tij, është për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988 të konventës “Për sigurinë e jetës në det” (SOLAS), e cila është propozuar nga Këshilli i Ministrave, kurse ne e shqyrtojmë si komision për dhënie mendimi.

Siç e tha edhe zëvendësministri, miratimi i këtij projektligji bëhet në zbatim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO-së për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Ky projektligj është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, ratifikuar në vitin 2006. Konkretisht, në pikën 2, neni 59 i kapitullit të tretë “Ofrimi i shërbimeve”, përcaktohet se palët angazhohen të respektojnë detyrimet ndërkombëtare dhe europiane në fushën e standardeve të sigurisë, sigurimit dhe mjedisit.

Ky projektligj synon të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e sigurisë lundrimore duke amenduar konventën “Për sigurinë e jetës në det” (SOLAS), është akt ndërkombëtar dhe sigurisht kemi detyrime që duhet t’i plotësojmë në kuadrin e këtij angazhimi.

Konventa Ndërkombëtare “Për sigurinë e jetës në det”, (SOLAS) është akt ndërkombëtar detar i aderuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 2004, i cili përcakton standardet minimale të sigurisë në ndërtimin, pajisjet dhe funksionimin e anijeve tregtare.

Duke iu referuar relacionit, aty shkruhet shprehimisht që konventa kërkon që shtetet nënshkruese të marrin të gjitha masat e nevojshme që të sigurojnë se anijet që mbajnë flamurin e tyre të jenë në përputhje me të paktën standardet e parashikuara në këtë konventë, për të kryer një lundrim sa më të sigurt duke mbrojtur jetën e njerëzve, pronës dhe mjedisin detar. Në fakt, për këtë do të doja pak më shumë informacion nga ministria në momentin që do ta prezantojë, për faktin se pavarësisht se në relacion thuhet që nuk ka angazhime apo detyrime financiare apo burime njerëzore, sigurisht këto angazhime kërkojnë një impenjim edhe monitorim të sigurisë së këtyre mjeteve lundruese.

Pavarësisht se, për sa i takon efekteve financiare ky projektligj ka për qëllim vetëm aderimin në protokollin e vitit 1988 të Konventës SOLAS, aderuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 2004, si dhe nuk ka nevojë për ndryshim strukture, shtim personeli apo të pajisjeve të institucioneve zbatuese, sërish unë kërkoj pak më shumë informacion nga ministria për monitorimin e zbatimit të saj, nëse janë kapacitetet e duhura dhe si do të realizohet kjo gjë për t'i përmbushur këto kritere.

Faleminderit, kryetare!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Përpara se të vazhdojmë me pyetje apo diskutime dua t'i them zëvendësministrit Xhafaj ta ketë parasysh kërkesën e drejtë të zonjës Gjermani lidhur me një informacion më të detajuar për zbatueshmërinë e kësaj konvente. Sigurisht flasim për sigurinë e jetës në det dhe angazhimin e më shumë se një institucioni që lidhet pikërisht me këtë gjë për të cilën jemi duke folur.

Sigurisht që ju jeni dikasteri përgjegjës, por të gjithë bashkë e dimë që për sigurinë e kufijve tanë në det dhe të mbarëvajtjes së punëve me detin dhe për detin ka një sërë institucionesh që janë të angazhuara për ta zbatuar këtë protokoll. Ndaj, besoj se brenda një kohe të arsyeshme, jeni të lutur ta dërgoni këtë informacion në mënyrë që deri në momentin e miratimit të tij kolegët deputetë të jenë më shumë të azhurnuar lidhur me atë çka po flasim.

Etjen Xhafaj – Patjetër, kryetare!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ka pyetje? Nuk ka

Kush është dakord me projektligjin në parim? Të gjithë janë dakord, duke përfshirë këtu edhe kolegun Velaj që është në krahun tim. Kundër dhe abstenim nuk ka

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E votojmë në tërësi.

E konsiderojmë pa votim kundër apo abstenim të miratuar projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e vitit 1988, në lidhje me konventën ndërkombëtare “Për sigurinë e jetës në det” të vitit 1974.

Faleminderit, kolegë, për angazhimin dhe mbështetjen!

Shihemi në seancë.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA